



01/Nr. 7458/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12 paragrafi 2 shkronja d, 14, 40, Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 06/L-005 neni 9, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 25, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.10.2020 merr:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE TË TATIMIT PËR PRONAT E PALUAJTSHME NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2021

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për caktimin e normave tatimore për të gjitha kategoritë e pronave të paluajtshme, me përjashtim të kategorisë pronës publike të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021.
2. Normat tatimore vendosen brenda kufijve të përcaktuar si më poshtë dhe janë të vlefshme nga fillimi i vitit tatimor 2021:

Nr.	Kategoria e pronës	Norma tatimore
1	Për njësitë bujqësore të parcelave	0.15%
2	Për njësitë bujqësore të objekteve	0.15%
3	Për njësitë pyjore të parcelave	0.15%
4	Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.15%
5	Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.15%
6	Për njësitë komerciale të parcelave	0.15%
7	Për njësitë komerciale të objekteve	0.20%
8	Për njësitë industriale të parcelave	0.15%
9	Për njësitë industriale të objekteve	0.20%

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Tatimit në Pronë.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Financave,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Zyra e Tatimit në Pronë,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 29.10.2020



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7441/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 12, paragrafi 12.2 shkronja d, 40 , Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 24 dhe sipas kërkesës së kompanisë N.P.L “Pastrimi” sh.a. 02/Nr.7441/2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.10.2020 merr:

**VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për kompaninë N.P.L “Pastrimi” Sh.a.
2. Shuma e mjeteve financiare e cila i ndahet kompanisë është 65,000.00 € (gjashtëdhjetë e pesë mijë euro), mjete të cilat do të merren nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.
3. Ky vendimi vjen si rezultat i kërkesës së kompanisë NPL “Pastrimi” sh.a nga kryeshefi ekzekutiv për nevojën e blerjes së kamionit të mbeturinave.
4. Per zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- NPL “Pastrimi” sh.a,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 29.10.2020





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7456/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.10.2020 merr:

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUdhËN JANAR
- SHTATOR 2020**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar -Shtator 2020.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar- Shtator 2020 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Buxheti i miratuar për vitin fiskal 2020 është në shumë prej 2,742,095.00 €, ndërsa buxheti përfundimtar është në shumë prej 3,000,535.28 €. Në kategorinë paga dhe shtesa shpenzimi është në shumë prej 1,166,961.03 € ose 73.43% , në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 180,134.18 € apo 50.23%, në kategorinë ekonomike shpenzime komunale shpenzimi është në shumë prej 34,377.14 € apo 55.45%, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 63,755.50 € apo 78.48%, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 296,029.78 € apo 38.81%. Totali i shpenzimit për periudhën Janar - Shtator 2020 është në shumë prej 1,741,257.63 € apo 58.03%. Të hyrat vetanake për këtë periudhë nëntëmuajore 2020 janë realizuar në shumë prej 179,646.66 € apo 56.52 %.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 29.10.2020



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr.7469/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 40, Ligji për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 neni 30, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 52, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.10.2020 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË BIZNESIT PËR VITIN 2021 PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE PËR NPL "PASTRIMI" SH.A HANI I ELEZIT

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e biznesit për vitin 2021 për Ndërmarrjen Publike Lokale për Menaxhimin e Mbeturinave N.P.L."PASTRIMI" SH.A Hani i Elezit.
2. Plani i biznesit për vitin 2021 për Ndërmarrjen Publike Lokale përmban gjithsej 21 (njëzet e një) faqe dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- N.P.L Pastrimi SH.A,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 29.10.2020

